

STATUTI DHE AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“2-FF” SH.P.K

Ne perputhje me Ligjin nr.9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar dhe ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007”Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, te ndryshuar, themelohet Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “2-FF” SH.P.K nga ortaket FRANÇESKA PEQINI me nr identifikimi J35322062P lindur me 22.03.1993 banues ne Rr.Selaudin Zorba, Lagjja NR.10, Njesia Bashkiake nr.4 Tirane .

Shoqeria eshte person juridik i te drejtes shqiptare dhe gezon te drejtat e personit juridik nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje te plote me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e aktit te themelimit e te ketij statuti.

Neni 1

EMERTIMI

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar do te emertohet “2-FF” SH.P.K

Neni 2

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NE FUSHEN E NDERTIMIT:

- *Ndertime te reja apartamente banimi, Godina sociale,punime ne rruge asfaltime e germime , komplekse turistike*
- *Sherbime ne ndertim te te gjitha llojeve betonime, armature , lidhje hekuri, suvatime, mure tulle, nivelime, shtrime pllakash veshje me kapot, elektrike e hidraulike*
- *Transporte te ndryshme brenda edhe jashte.*
- *Tregeti te ndryshme*
- *Prodhime betoni*

- *Tregeti: Te te gjitha llojeve,ushqimore, veshmbathje, butik, hotele, guzhina, restorante e tjera.*

- *Importe: Te gjitha llojeve, transporte,ushqimore, veshmbathje, elektrike, hidraulike, kancelari, pllaka, mjete dhe tregetimi i tyre.*

Neni 3

SELIA E SHOQERISE

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar ka seline e saj ne adresen: **Rruga Lluk Kacaj, kati II, Zona kadastrale nr. 8120, lagjja nr.10, Njesia Bashkiake nr.4 Tirane.** Do transferoje, apo te suprimoje qendra administrative, seli, filiale, agjensi dhe zyra ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte vendit

Neni 4

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete pa afat, me mundesine e zgjatjes apo te shkurtimit te afateve, te ndryshoje veprimtarine, emertimin, seline, objektin e veprimtarise sipas vendimit te ortakeve te shoqerise


Neni 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 200.000 leke, i ndare ne nje kuote e barabarta me 200.000 leke zoteruar nga ortak i vetem **FRANÇESKA PEQINI** me 100% te kuotave

- Ky kapital eshte shlyer teresisht nga ortaku i vetem

NENI 6



Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

(1) Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nenshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

(2) Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve, duke marrë me shumicën e kualifikuar të votave. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

TRANSFERIMI I KUOTAVE

Ortakët mund të kalojnë pjesën nga kapitali themeltar ndaj personave të Tretë në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 73 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Kuota dhe të drejtat që rrjedhin prej saj mund të fitohen apo kalohen nepermjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë
- shitblerjes
- trashëgimise
- dhurimit
- çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Neni 8

DETYRIMET E ORTAKEVE

Ortakët e shoqërisë duhet të kryejë depozitimin e kapitalit themeltar për llogari të shoqërisë në një bankë të caktuar prej tyre.

Ortaku gëzon këto të drejta kryesore:

- Pjesëmarrjen në rezultatet e çdo forme dhe sasi të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në kontratën dhe statutin e saj.
- Marrjen e të gjitha të dhënave që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarinë e shoqërisë, si dhe me të gjithë dokumentat e përpunuara nga shoqëria, bilanci si dhe llogaritë ekonomike etj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblese së Ortakut.
- Të heqë dorë nga shoqëria.
- Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare të marra me parë ndaj shoqërisë.
- Të marrë pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nepermjet përfaqësuesve të tij ose vete.
- Të kërkojë t'i japin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen prodhuese dhe tregtare të shoqërisë, si dhe të gjithë dokumentat e përpunuara të shoqërisë, si bilanci, llogaritë ekonomike etj.
- Të bëjë propozime dhe t'i paraqesë ato për shqyrtim para organeve të shoqërisë.
- Të emerojë dhe të shkarkojë përfaqësuesit e tij, punonjësit, ekspertin kontabel dhe likuidatorët.

Ortaku ka këto detyrime kryesore:

- Të depozitojë kuotën e tij në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Të marrë pjesë në administrimin e shoqërisë nepermjet organeve të krijuara nga vete ai.
- T'i japë shoqërisë të dhënat e domosdoshme për përpunimin e çdo objekti të vecantë lidhur me veprimtarinë e saj.
- Të kryejë detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.
- Ortaku ka të drejtë të heqë dorë nga shoqëria, duke i njoftuar vendimin e tij asamblese së ortakut në rast shtimi të ortakëve 6 muaj përpara dhe duke cëduar të drejtën e zgjedhjes.
- Heqja dorë nuk e liron ortakun nga detyrimet e marra me parë ndaj shoqërisë dhe nuk pezullon detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut.

- Ti japi shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.
- Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.
- Pjesemarrja ne shoqeri nuk i pengon ortaket te kene pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie. Ai nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj tej kapitalit themelor ku ata kane marre pjese.

Neni 9

OPERACIONET FINANCIARE

Shoqeria eshte e autorizuar per te siguruar mjete financiare ti drejtohet bankave, institucioneve te kreditit ose atyre te financimeve totale apo te jashtme, institucioneve nderkombetare te financimit dhe te kreditit sido qe te jete percaktuar.

Neni 10

BLERJET E SHOQERIVE

Shoqeria disponon mjetet e saj ne perputhje me destinacionin e tyre dhe me objektin e shoqerise. Ne Republiken e Shqiperise, shoqeria gezon te drejten e saj per te zoteruar mjete te saj si ne cdo shoqeri tjetere ose organizate tregtare, kombetare shqiptare ne perputhje me Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

FONDI REZERVE

Neni 11

Shoqeria mund te themeloje nje fond rezerve si dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin e tij. Perberja, shuma totale, fondet per krijimin e tyre perdorimi dhe rregullimi i tyre (i cdo fondi) percaktohet nga Asambleja e ortakeve ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Vlerat materiale te shoqerise raportohen ne bilance te shprehur ne leke shqiptare, ne perputhje me rregullat ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Bilanci dhe perlogaritjet ekonomike te shoqerise hartohen mbi bazen e formes se bilancit dhe llogaritjeve ekonomike te percaktuara per shoqerite tregtare ne Shqiperi. Bilanci vjetor mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti.

ORGANET E SHOQERISE

Neni 12

Organi vendimmarres i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) cheshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambleja e pergjithshme merr vendime per cheshtjet e percaktuara ne shkronjat "e" dhe "ë" te pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakeve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar nëto, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;

c) investime;

ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i tretë ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

MBLEDHJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

Neni 13

Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji 9901, date 14.04.2008, nga ligje të tjera dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktivet, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

MËNYRA E THIRRJES

Neni 14

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

KËRKESA NGA ORTAKËT E PAKICËS

Neni 15

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.

Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e këtij statuti.

Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas

gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE

Neni 16

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

KUORUMI

Neni 17

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të Ligjit 9901, date 14.04.2008, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

MARRJA E VENDIMEVE

Neni 18

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të ligjit për shoqëritë tregtare, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË

Neni 19

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.


Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

ADMINISTRATORI

Neni 20



Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar administrohet nga nje ose disa persona fizike.
Administratori i shoqerise emerohet me vendim te Asamblese se Ortakut te shoqerise. Afati i qendrimit ne detyre i administratorit te shoqerise eshte per nje periudhe 5 (pese) vjecare.
Administrator i kesaj shoqerie eshte **FRANÇESKA PEQINI** me **ID.J35322062P**
Administratori i shoqerise i ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe u njeh ligji shprehimisht Asamblese se Ortakeve ose te treteve.
Administratori ka pergjegjesi ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkeljete ligjeve, statutit apo shkeljeve te kryera gjate administratimit. Administratori ne rastin konkret kryen dhe harton raportet financiare, llogarite vjetore etj.

RAPORTET E PUNES

Neni 21

Raportet e punes ndermjet shoqerise, filialeve dhe agjensive te saj si dhe te punonjesve ne te, rregullohen ne baze te kontrates se punes, konform Kodit te Punes.

Per sa nuk parashikohet ne kontraten e punes, aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Shoqeria merr persiper, te shlyeje rregullisht te gjitha detyrimet e saj qe burojne nga legjislacioni per sigurimet shoqerore e shendetesore lidhur me te punesuarit e saj.

PERFUNDIMI I AKTIVITETIT

Neni 22

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar prishet:

- 1.Me kalimin e afatit per kohezgjatjen e saj ne kontraten e themelimit.
- 2.Per pamundesine e realizimit te objektit te saj.
- 3.Me vendimin e gjykates.
- 4.Me hapjen e procedurave te falimentit.

LIKUJDIMI

Neni 23

Likujdimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar do te behet sipas normave te legjislacionit shqiptar ne fuqi ne kohen e likujdimit

KUSHTET E TJERA

Neni 24

Te gjitha vendimet e mara nga asambleja e ortakeve te shoqerise evidentohen ne nje liber te vecante, i cili administrohet ne seline e shoqerise.

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht dhe saktesisht ne kete, statut do ti referohen plotesimeve qe mund te beje Asambleja e ortakeve, si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Per shoqerine tregtare "2-FF" SH.P.K

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

FRANÇESKA PEQINI

Tirane, me 17.06.2024

Franceska Peqini

